



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kms hc.al



www.kms hc.al

23 MAJ 2025

NJOFTIM

NJOFTIM PËR PËRMBYLLJEN E PROCESIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL ME OBJEKT VEPRIMTARIE: EMËRIMET E REJA DHE SJELLJA E NËPUNËSVE CIVILE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Duke pasur parasysh se situata zgjedhore paraqet rrezik të shtuar për shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga ana e institucioneve pjesë e këtij sistemi apo për përfshirjen e nëpunësve civilë në fushatat e organizuara nga subjektet politike, duke cenuar integritetin dhe parimin e paanësisë e neutralitetit të shërbimit civil;

Me synimin për të kontribuar në ndryshimin e sjelljes së administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, drejt standardeve evropiane; në zbatim të parimeve të mësipërme të administrimit të shërbimit civil; me qëllim që administrata të orientohet drejt zbatimit të detyrave funksionale në shërbim të shtetit dhe publikut dhe jo në ndihmë të subjekteve zgjedhore;

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që përkon me datat 11 prill – 11 maj 2025, Komisioneri, si watchdog i zbatimit të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, monitoroi zbatimin këtij ligji, me fokus emërimet e reja dhe sjelljen e nëpunësve civilë gjatë këtij procesi.

Në përfundim të tij, Komisioneri ka hartuar e më tej miratuar një Raport Vlerësimi për situatën, me Nr. 25, datë 23.05.2025, i cili gjendet i publikuar në faqen e internetit të institucionit www.kms hc.al.